



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e **parë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **24.4.2024** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. “UÇK”, nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM 1);
3. Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024;
4. Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunktional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës-Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit;
5. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës Sociale Edukative “Don Bosko”;
6. Propozim-vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010;

F.K.

7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani;
8. Propozim-vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara;
9. Propozim- vendimi sipas të cilit duhet të mirëmbahen të gjitha hapësirat publike ose private, vizualisht të dukshme nga rruga apo të cilat ndikojnë në mjedisin përreth, në pamjen vizuale dhe të pastër të Kryeqytetit;
10. Diskutim lidhur me zyrtarizimin e Parkut memorial “ Të Pagjeturit”;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-48066/24, më 12.4.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

